

VENDIM

PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK TE DEGES SE SHOQERISE
TREGETARE

"ZBULO FATIN" SH.A.

Sot me daten 11 Tetor 2002, une *Vilma Nushi*, gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Majlinda HIDO, me ane te se ciles ajo kerkon rregjistrimin e shoqerise "ZBULO FATIN" SH.A. PA OFERTE PUBLIKE

KONSTATOVA

Kerkuesja Majlinda HIDO ka bere kerkesen prane kesaj gjykate, me ane te se ciles kerkon rregjistrimin e shoqerise "ZBULO FATIN" SH.A. PA OFERTE PUBLIKE.

Shoqeria ka objektin e aktivitetit si me poshte:

Ushtrim i veprimtarise ne fushen e lojrave te fatit, te percaktuar ne Ligjin Nr.8701 date 1.12.2000 "Per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet".

1. Kapitali themeltar eshte 10.000.000 (dhjete milione) Leke, i ndare si me poshte:
 - a. Aksioneri Vilma Nushi, me 100 % (per/qind) te aksioneve, me vlere te pergjithshme 10.000.000 (dhjete milion) Leke, te Kapitalit me numer te aksioneve nga nr. 1 deri tek nr. 100.

Selia e Shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes ne adresen : Rruga "Dede GJOLULI", Nr. 3/1, Tirane, Shqiperi, me kohezgjatje jo me pak se 20 vjet.
Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise eshte Majlinda HIDO.

Kerkesa e saj eshte bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETE ARSYE

Duke u bazuar ne dokumentacionin e paraqitur dhe Ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare",

VENDOSA

1. Pranimin e kerkeses se kerkueses Majlinda HIDO, per rregjistrimin e shoqerise "ZBULO FATIN" SH.A. PA OFERTE PUBLIKE me objekt:
Ushtrim i veprimtarise ne fushen e lojrave te fatit, te percaktuar ne Ligjin Nr.8701 date 1.12.2000 "Per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
Nr. 28.385/1 i Vendimit

VENDIM
I
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 23.06 2005, unë M. Ullari, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkueses, Znj. Majlinda Hido, me cilësinë e Drejtores të shoqërisë tregtare "ZBULO FATIN" Sh.a., mbi depozitimin e vendimit të Aksioneres së Vetme, datë 22.06.2005,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "ZBULO FATIN" sh.p.k. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.28385, datë 11.10.2002 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Kërkuësja, Znj. Majlinda Hido, me cilësinë e Drejtores të shoqërisë tregtare "ZBULO FATIN" Sh.a., kërkon depozitimin e vendimit të Aksioneres së Vetme, datë 22.06.2005, me anën e të cilit është vendosur ndryshimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë, si më poshtë vijon:

- *Aktivitet në fushën e lojrave të fatit.*
- *Të blejë apo zotëroj në ndonjë mënyrë tjetër, të importojë, magazinojë, ruaj, eksportoj, apo të tregtojë, me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme, përfshirë ato ushqimore, bujqësore, blektorale, industriale, lëndë të para e minerale, kimikate dhe çdo lloj malli tjetër, si dhe shitjen me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve.*

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e vendimit të Aksioneres së Vetme të shoqërisë "ZBULO FATIN" sh.a., datë 22.06.2005, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.


PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Aksioneres së Vetme të Shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.a., datë 22.05.2005, i cili ka vendosur për ndryshimin e objektit të veprimtarisë, sipas mënyrës së përcaktuar më sipër.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kollonën përkatëse

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE


V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 12.07/2005, une *[Signature]* gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e bere nga zonja Majlinda Hido me cilesine e Drejtores se shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a., Tirane, lidhur me transferimin e selise se shoqerise ne nje adrese te re,

KONSTATOVA SE

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.28385, dt.11.10.2002 eshte bere regjistrimi ne Regjistrin Tregtar prane kesaj gjykate i shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a., me aksionere te vetme zonjen Vilma Nushi.

Kerkuesja znj. Majlinda Hido, me cilesine e Drejtores se shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a., kerkon depozitimin e vendimit te aksioneres se vetme nr.23/05, dt.27.06.2005, me ane te te cilit eshte vendosur :

Transferimi i selise se se shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a. nga adresa Rr."Dede Gjon Luli", P.3/1 Tirane, **ne adresen e re : Katundi i Ri – Kashar, Autostrada Tirane – Durres, kilometri 10, Tirane.**

Per sa me sipër, kerkesa e paraqitur per depozitimin e vendimit te aksioneres se vetme te shoqerise "ZBULO FATIN"sh.a. nr.23/05, dt.27.06.2005 eshte plotesisht e bazuar dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit nr.7638, dt.19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr.7667, dt.28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A

1. Pranimin e kerkeses.
2. Depozitimin e vendimit te aksioneres se vetme te shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a. nr.23/05, dt.27.06.2005 per transferimin e selise se shoqerise ne nje adrese te re.
3. Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar per pasqyrimin e ndryshimit ne kollonen perkatese.
Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE
[Signature]

Mediën negidriim:

28385

- Overtommi "Fhulo Fotu, M.A.
- Tzipitel: 10.000.000 lili.
- Tolezgotje amb 100pt
- Me vjgent dogro fol
- Me olen ou to vetur Vilmo Nu

Statuta o flir

olit the mela 2 flir

Olote e vishen, op 10.200-

Olote e meg. vishen !A 10.200-

CMZ^{top}
[Signature]

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ANONIME "ZBULO FATIN" SH.A.
PA OFERTE PUBLIKE



1. Ne te nenshkruarit si me poshte:
 - a. **Vilma NUSHI**, e bija e Besnikut, me kombesi e shtetesi shqiptare, e datelindjes 30 Qershor 1961, me pasaporte numer 0012159, banues ne adresen Rr."Dede GJOLULI", Nr. 3/1 - Tirane.

Qe ne vijim do te quhen Aksionere, te mbledhur sot ne Tirane me daten 08.10.2002, vendosen te themelojne Shoqerine Anonime pa oferte publike me emer "ZBULO FATIN" SH.A, me poshte e quajtur Shoqeria.


2. Shoqeria do te ushtroje aktivitet ne Republiken e Shqiperise si me poshte:
Objekt: Ushtrim i veprimtarise ne fushen e lojrave te fatit, te percaktuar ne Ligjin Nr.8701 date 1.12.2000 "Per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet".
3. Selia e Shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes ne adresen : Rr."Dede GJOLULI", Nr. 3/1. Shoqeria ka te drejte te hape filiale, dege apo zyra perfaqesimi ne perputhje me Statutin e shoqerise.
4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte dhjete milion (10.000.000) Leke, i ndare ne aksione me vlere nominale 100.000 (njqind mije) Leke, ne 100 Aksione te numeruara nga 1 deri tek 100. Aksioneret themelues te shoqerise zoterojne aksione, perqindje ne kapital dhe numer rendor aksionesh si me poshte:
 - a. **Aksioneri Vilma Nushi, me 100 % (per/qind) te aksioneve, me vlere te pergjithshme 10.000.000 (dhjete milion) Leke, te Kapitalit me numer te aksioneve nga nr. 1 deri tek nr. 100.**

Menyra e transferimit te aksioneve te treteve percaktohet ne Statutin e Shoqerise.

5. Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise eshte Majlinda HIDO.
Keshilli Mbikqyres i Shoqerise perbehet nga tre anetare. Anetare te pare te Keshillit Mbikqyres jane:

| | |
|-------------------|---------|
| Artan NUSHI | Kryetar |
| Artur MARIKA | Anetar |
| Neriman ZAGONJORI | Anetar |


6. Kohezgjatja e mandatit te Drejtorit dhe te anetareve te Keshillit Mbikqyres do te jete sipas percaktimeve ne Statutin e Shoqerise.
7. Shoqeria do te ushtroje veprimtari per nje afat kohor jo me pak se 20 vjet.

- 
8. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me Aktin e themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.
Per sa nuk parashikohen ne Aktin e Themelimit dhe Statut do te zbatohet ligji Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare"

Shoqeria autorizon Drejtorin e saj te kryeje te gjitha veprimet per rregjistrimin e shoqerise ne regjistrin tregetar dhe ne zyrat e tjera ose organet shteterore, ku kerkohet detyrimisht te kryhet regjistrimi i saj.

Aksioneret themelues

Vilma NUSHI



Tirane me 09.10.2002

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 1259 REP.
NR. 127 KOL.


VERTETIM

Vertetohet se sot me daten 09.10.2002, ne Tirane para meje Mimoza Papa, notere publike me seli ne Tirane, rruga Rreshit Collaku, pallatet e Shallvareve, nr.7/1, u paraqit personalisht:

Vilma NUSHI, e bija e Besnikut, me kombesi e shtetesi Shqiptare, e datelindjes 04.05.1958, me pasaporte nr.0012159 dhe adrese Rruga "Dede GJOLULI", NR.3/1, Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e cila me deklaroi se e ka hartuar kete akt, jashte kesaj zyre, me vullnet te lire e te plote dhe nenshkroi rregullisht para meje sipas ligjit. Une noteri e shikoj se ky veprim eshte kryer konform ligjit dhe e vertetoj me nenshkrimin tim sipas ligjit.

NOTERE

MIMOZA PAPA





STATUTI
I SHOQERISE ANONIME "ZBULO FATIN" SH.A
PA OFERTE PUBLIKE

Neni 1
Emertimi

Aksioneret kane themeluar shoqerine Anonime pa Oferte Publike me emrin "ZBULO FATIN" SH.A, me poshte e quajtur Shoqeria.

Neni 2
Themelimi

Shoqeria e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit, me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 3
Selia


Shoqeria e ka seline e saj ne adresen: " Tirana Business Centre", Bulevardi "Zogu i Pare", Tirane Shqiperi.
Shoqeria mund te hape filiale, dege ose zyra perfaqesimi ne qytetet e tjera te Republikes se Shqiperise dhe /ose jashte saj, me vendim te Asamblese se Zakonshme te Aksionereve.

Neni 4
Kapitali

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 10.000.000 (dhjete miljone) Leke dhe eshte i ndare me 100 (njeqint) aksione nominative me vlere nominale 100.000 (njeqind mije) Leke secili. Kapitali i Shoqerise i nenshkruar shlyhet qe ne momentin e regjistrimit te Shoqerise si person juridik. Aksionet jane te numeruara nga numeri nje deri ne njeqind. Ndarja e aksioneve dhe perqindjet e zoterimit te aksionereve ne Kapitalin e Shoqerise jane si me poshte:

- a. Aksioneri Vilma Nushi, me 100 % (per/qind) te aksioneve, me vlere te pergjithshme 10.000.000 (dhjete milion) Leke, te Kapitalit me numer te aksioneve nga nr. 1 deri tek nr. 100.

Transferimi i aksioneve me perjashtim te trashegimise i nenshtrohet pelqimit paraprak te aksionereve te tjere. Aksioneret e Shoqerise gezojne te drejten e parablerjes se aksioneve, ne rast se njeri nga aksioneret kerkon ti transferoje ato. Aksioneri i cili deshiron te transferoje aksionet e tij te tretteve, duhet t'u permbahet



klauzolave te nenit 207 te Ligjit nr, 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".
Aksioneret pergjigjen per detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise.

Neni 5 Objekti

Shoqeria ka objektin e aktivitetit si me poshte:
Ushtrim i veprimtarise ne fushen e lojrave te fatit, te percaktuar ne Ligjin Nr.870, date 1.12.2000, "Per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet".

Neni 6 Kohezgjatja


Kohezgjatja e Shoqerise do te jete jo me pak se 20 vjet, duke filluar nga momenti regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregetar.
Ky afat nuk zbatohet ne rast se shoqeria nuk arrin te licensohet ne perputhje me Ligjin Nr.870, date 1.12.2000, "Per lojrat e fatit, kazinot dhe hipodromet".

Neni 7 Asambleja e Aksionereve

Asambleja e Aksionereve eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise dhe vendimet e saj jane te detyrueshme per te tere aksioneret.
Te drejten e thirrjes se mbledhjes se Asamblese e kane Keshilli Mbikqyres ose Drejtoria e Shoqerise.
Gjithashtu ajo mund te thirret nga eksperti kontabel i autorizuar ose nga aksioneret te cilet zoterojne te pakten 1/10 e Kapitalit Themeltar te Shoqerise. Njoftimi per thirrjen e Mbledhjes se Asamblese se Aksionereve behet te pakten 15 dite perpara dates se Mbledhjes se Aksionereve, duke parashtruar rendin e dites dhe dokumentacionin qe do te shqyrtohet.
Votat e aksionereve kane vlere proporcionale me pjesen e tyre ne kapitalin e Shoqerise. Cdo aksioner ka te drejten e nje vote. Cdo aksioner mund te perfaqesohet ne Asamble nepermjet nje aksioneri tjeter os enepermjet nje perfaqesuesi, duke qene keta te autorizuar me prokure te posacme, dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Neni 8 Asambleja e Jashtezakonshme

Asambleja e Jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare nese jane te pranishem 2/3 e aksionereve qe zoterojne aksione me te drejte vote. Ne rast se ku quorum nuk arrihet mbledhja do te shtyhet per nje date te mevonshme jo me te larget se 2 muaj nga data e thirrjes se pare. Ne mbledhjen e dyte, Asambleja eshte ne gjendje te marre vendime te vlefshme nese jane te pranishem ose te perfaqesuar te pakten 1/4 e aksionereve qe zoterojne aksione me te drejte vote.
Asambleja e Jashtezakonshme merr vendime me 3/4 e votave te aksioneve te pranishme ose te perfaqesuar ne mbledhje.



Asambleja e Jashtezakonshme:

- Vendosi te shtoje, ndryshoje ose te zevendesoj me nje statut te ri kete statut te Shoqerise.
- Vendosi zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit
- Vendosi prishjen e shoqerise ose likuidimin e saj.

Vendosi ne lidhje me cdo ceshtje tjeter qe njihet nga Ligji, Akti i Themelimit te Shoqerise ose ky Statut.

Neni 9

Asambleja e Zakonshme

Asambleja e Zakonshme ka te drejte te marre ato vendime te cilat jane te parashikuara ne nenin 129 dhe 130 te Ligjit nr, 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

Asambleja e Zakonshme merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare ne rast se aksioneret e pranishem dhe te perfaqesuar zoterojne te pakten 1/4 e Kapitalit Themeltar te Shoqerise, me te drejte vote. Ne rast se ky raport nuk arrihet, mbledhja do te shtyhet per nje date mevonshme. Ne mbledhjen e dyte nuk eshte i nevojshem raporti.

Asambleja e Zakonshme merr vendime me shumicen e votave te aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar te cilet zoterojne aksione me te drejte vote.

Asambleja e Zakonshme:

- Emeron Keshillin Mbikqyres dhe Ekspertin Kontabel te Autorizuar te Shoqerise.
- Percakton shperblimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres.
- Miraton pjesmarrjen ne shoqeri te tjera.
- Miraton bilancin
- Cdo vendim tjeter qe i njihet nga ligji, Akti i Themelimit te Shoqerise ose ky Statut.

Neni 10


Drejtori

1. Funksionet dhe Kompetencat

Ne momentin e themelimit Shoqeria perbehet nga nje Drejtor. Drejtori i shoqerise eshte Majlinda HIDO, e datelindjes 04.05.1958, me pasaporte nr.0571013 dhe adrese Rruga "Dede GJOLULI", NR.1, Tirane.

Drejtori i Shoqerise perfaqeson Shoqerine ne marrdheniet me te tretet dhe ushtron te gjitha ato kompetenca qe i njeh ligji me perjashtim te atyre qe ligji, Akti i Themelimit te Shoqerise dhe ky Statut ua njeh Asamblese se Aksionereve ose Keshillit Mbikqyres. Drejtori te pakten nje here ne tre muaj duhet t'i paraqese Keshillit Mbikqyres me qellim kontrolli dhe verifikimi, raportin mbi administrimin e pergatitur prej tij. Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar te Shoqerise, Drejtori duhet t'i paraqese Keshillit Mbikqyres raportin financiar vjetor dhe bilancin vjetor te shoqerise, me qellim kontrolli dhe verifikimi.

Drejtori i Shoqerise nuk ka te drejte te marre apo te jape hua nga dhe per te tretet, per llogari dhe ne emer te shoqerise.



Emertimi dhe Kohezgjatja e Mandatit

Drejtori emerohet nga Keshilli Mbikqyres me nje shumice votash dhe do te qendrojne ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh.

Drejtori do te qendroje ne detyre deri ne momentin e emerimit te zevendesit te tij si Drejtor, ose deri ne momentin e doreheqjes, shkarkimit ose vdekjes se tij.

3. Vendi vakant

Ne rast se posti i Drejtorit mbetet vakant per shkak te doreheqjes, shkarkimit apo vdekjes se tij, ai do te zevendesohet nga nje person tjeter, i emeruar me vendim te Keshillit Mbikqyres, i cili do te qendrojne ne kete detyre deri ne perfundim te mandatit te drejtorit te cilin zevendeson, ose te zgjedhjes te Drejtorit te ri.

Drejtori mund te shkarkohet per shkaqe te perligjura me vendim te Keshillit Mbikqyres te marre me shumice te thjeshte votash te anetareve te tij.

3. Pergjegjesite

Drejtori eshte individualisht pergjegjes ndaj Shoqerise apo te treteve per demet e shkaktuara per shkak te shkeljes se dispozitave te parashikuara ne Aktin e Themelimit te Shoqerise, ne kete Statut, ose ne ligj.

Neni 11

Keshilli Mbikqyres

1. Funksioni, Kompetencat dhe Shperblimi

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll mbi Drejtorin ne lidhje me drejtimin e shoqerise. Keshilli Mbikqyres verifikon dhe kontrollon raportin e administrimit, raportin financiar vjetor dhe bilancin e paraqitur nga Drejtori perpara se ato te aprovohen nga Asambleja e Aksionereve.

Asambleja e Aksionereve mund te caktojne nje shume fikse vjetore si shperblim per anetaret e Keshillit Mbikqyres per sherbimet e tij.

Keshilli Mbikqyres do te kete kompetencen qe rast pas rasti te autorizojne pagimin e shpenzimeve te vecanta ne lidhje me sherbimet e tij.

2. Numri i Anetareve

Keshilli Mbikqyres do te kete tre anetare.

Keshilli i pare Mbikqyres do te kete kete perberje:

| | |
|-------------------|---------|
| Artan NUSHI | Kryetar |
| Artur MARIKA | Anetar |
| Neriman ZAGONJORI | Anetar |

3. Emerimi, Zgjedhja dhe Kohezgjatja e Mandatit.

Cdo person i emeruar anetar i Keshillit te pare Mbikqyres ne paragrafin 2 te ketij neni do te qendrojne ne detyre per tre vjete rrjesht.

Me perfundimin e afatit te siperpermendur, Asambleja e Aksionereve do te emerojne Keshillin e Ri Mbikqyres ne perputhje me ligjin.

Cdo anetar i Keshillit Mbikqyres do te qendrojne ne kete detyre per tre vjete rrjesht.

4. Shkarkimi nga detyra

Cdo anetar i Keshillit Mbikqyres mund te shkarkohet ne cdo moment me vendim te Asamblese se Aksionereve



5. Vendi i Mbledhjeve

Keshilli Mbikqyres mund ti zhvilloje mbledhjet si brenda ashtu dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise ne vendin e caktuar rast pas rasti nga vete Keshilli. Ne qofte se vendi i mbledhjes nuk eshte caktuar ky vend do te jete selia e shoqerise.

6. Njoftimi i mbledhjeve

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te zhvillohen pasi te jene njoftuar 14 (katërmbëdhjetë) dite perpara, ne ditën dhe orën e caktuar rast pas rasti nga Keshilli Mbikqyres. Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te thirren nga Kryetari i tij duke njoftuar cdo anetar nepermjet telefonit, postes, postes elektronike ose me telegram ku percaktohet koha, vendi, rendi i dites qe od te shqyrtohen ne mbledhje.

7. Votimi

Keshilli Mbikqyres eshte ne gjendje te marre vendime kur ne mbledhjen e pare jane te pranishem me shume se gjysma e anetrave te tij. Vendimet merren gjithnje me shumice votash te anetareve te pranishem ne mbledhje. Ne qofte se quorumi i siperpermendur nuk arrihet, shumica e anetareve te pranishem mund te shtyjne mbledhjen ne nje date dhe ore tjeter.

Ne rast se votimi per marrjen e nje vendimi rezulton me numer te barabarte votash, atehere vota e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres eshte percaktuese.

8. Pergjegjesite

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane pergjegjes per gabimet personale te kryera gjate ushtrimit te mandatit te tyre.

Ne rast se anetaret e Keshillit Mbikqyres kane dijeni per faje te bera nga anetaret e drejtorise dhe nuk ia njoftojne ato Asamblese se Aksionereve, konsiderohen pergjegjes per keto faje.

Neni 12

Ekspertet Kontabel te Autorizuar

Asambleja e Aksionereve do te emeruje nje Ekspert Kontabel te autorizuar. Eksperti Kontabel i autorizuar do te qendroje ne detyre per nje vit financiar te Shoqerise. Per vitin e pare financiar ekspert kontabel do te jete "STUDIO ELB Sh.p.k."

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar do te filloje ne datën e regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregetar shqiptar dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor 2002.

Neni 14

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me Aktin e themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Per sa nuk parashikohen ne Aktin e Themelimit dhe Statut do te zbatohet ligji Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare"

Neni 15
Mosmarreveshjet

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti, si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet Shoqerise dhe te treteve do te zgjidhen nga gjykata Shqiptare.


Neni 16
Shtesa dhe ndryshime

Ky Statut mund te shtohet, ndryshohet ose zevendesohet me nje Statut te ri me vendim te Asamblese se Aksionereve.

Nenshkruar sot me daten 09.10.2002

AKSIONERET THEMELUES

Vilma NUSHI




REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 1759 REP.
NR. 127 KOL.

VERTETIM


Vertetohet se sot me daten 09.10.2002, ne Tirane para meje Mimoza Papa, notere publike me seli ne Tirane, rruga Rreshit Collaku, pallatet e Shallvareve, nr.7/1, u paraqit personalisht:

Vilma NUSHI, e bija e Besnikut, me kombesi e shtetesi Shqiptare, e datelindjes 04.05.1958, me pasaporte nr.0012159 dhe adrese Rruga "Dede GJOLULI", NR.3/1, Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e cila me deklaroi se e ka hartuar kete akt, jashte kesaj zyre, me vullnet te lire e te plote dhe nenshkroi rregullisht para meje sipas ligjit. Une noteri e shikoj se ky veprim eshte kryer konform ligjit dhe e vertetoj me nenshkrimin tim sipas ligjit.



NOTERE

MIMOZA PAPA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 3167 Rep.

Nr. 380 Kol.

VËRTETIM

Sot më datë 23/6/2005, para meje noterite Shirlex Jafa, Noter pranë
Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht, Majlinda Hido, shqetase
shqiptare, e bija e Besnikut dhe e Shpresës, e datëlindjes 04.05.1958, lindur dhe
banuese në Tiranë, në adresën Rruga "Ded Gjon Luli", Nr. 3/1, madhore me zotësi
të plotë për të vepruar, me identitetin e të cilës u njoha nëpërmjet pasaportës me
nr. 0571013, e cila me deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre,
dhe të nënshkruar me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova
ate sipas ligjit.

NOTER

Shirlex Jafa
Hido

PULLE TAKSE



**SHOQËRIA TREGTARE
ZBULO FATIN SH.A.**



VENDIM
I
AKSIONERES SË VETME

Sot, më datë 22.06.2005, në selinë e shoqërisë në Tiranë, u mbajt mbledhja e Aksioneres së Vetme, për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës të njoftuar sipas rregullave në fuqi, si më poshtë vijon:

- 1- Për ndryshimin e objektit të shoqërisë;
- 2- Të ndryshme.

Aksionerja e Vetme e Shoqërisë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar, procedoi me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës. Aksionerja konstatoi se ushtrimi i aktivitetit të shoqërisë kërkon përshatjen e saj me zhvillimin që ka pasur veprimtaria e shoqërisë. Për këtë arsye kërkohet ndryshimi i objektit të veprimtarisë.

Kështu Aksionerja e Vetme e shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.a., në mbështetje me legjislacionin tregtar në fuqi, vendosi të bëjë ndryshimin e objektit të veprimtarisë, si më poshtë vijon:

Objekti i veprimtarisë i cili është:

Ushtrimi i veprimtarisë në fushën e lojrave të fatit, të përcaktuar në ligjin nr. 8701, datë 01.12.2000 "Për Lojrat e Fatit, Kazinotë dhe Hipodromet"

Ndryshon në këtë mënyrë:

Shoqëria ushtron aktivitetet me objekt veprimtarie si më poshtë:

- ***Aktivitetet në fushën e lojrave të fatit.***
- ***Të blejë apo zotëroj në ndonjë mënyrë tjetër, të importojë, magazinojë, ruaj, eksportoj, apo të tregtojë, me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme, përfshirë ato ushqimore, bujqësore, blektorale, industriale, lëndë të para e minerale, kimikate dhe çdo lloj malli tjetër, si dhe shitjen me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve.***

Për pikën e parë të rendit të ditës, Aksionerja e Vetme miraton shtimin e objektit të shoqërisë, sipas mënyrës së treguar më sipër.

Në përfundim dhe duke mos patur pikë tjetër për diskutim, Aksionerja e Vetme, në mbështetje të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare",



VENDOSI:

1- Ndryshimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.a. si më poshtë vijon:

- *Aktivitet në fushën e lojrave të fatit.*
- *Të blejë apo zotëroj në ndonjë mënyrë tjetër, të importojë, magazinojë, ruaj, eksportoj, apo të tregtojë, me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme, përfshirë ato ushqimore, bujqësore, blektorale, industriale, lëndë të para e minerale, kimikate dhe çdo lloj malli tjetër, si dhe shitjen me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve.*

2- Ngarkohet Drejtorja e Shoqërisë Znj. Majlinda Hido, për depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

AKSIONERJA E VETME

Vilma NUSHI

ZBULO FATIN sh.a
Rr. "Ded Gjon Luli" No. 3/1
TIRANA - ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 DHOMA E NOTERISË TIRANË
 Nr. 316 Rep.
 Nr. 387 Kol.

V È R T E T I M

Sot më datë 23/6/2005, para meje noterit Shirvan Pasha, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht, Znj Vilma Nushi, shtetase shqiptare, e bija e Besnikut dhe e Shpresës, e datëlindjes 30.06.1961, lindur dhe banuese në Tiranë, në adresën Rruga “Ded Gjon Luli”, Nr. 3/1, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, me identitetin e të cilës u njoha nëpërmjet pasaportës me nr. 0012159, e cila me deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre, dhe të nënshkruar me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Shirvan Pasha
 H
 R



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3597 Rep.

Nr. 125 Kol.



VERTETIM

Sot me dt 11/4/2005, perpara meje notere Merita Paj, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane, u paraqit personalisht znj. Majlinda Hido, shtetase shqiptare, e bija e Besnikut dhe e Shpreses, e datelindjes 04.05.1958, lindur dhe banuese ne Tirane, ne adresen Rr."Dede Gjon Luli", P.3/1, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me identitetin e te ciles u njoha nepermjet pasaportes me nr.0571013, e cila me deklaroi permbajtjen e ketij akti te hartuar jashte kesaj zyre dhe te nenshkruar me vullnetin e saj te lire dhe te plote, dhe une noterja e vertetova ate sipas ligjit.

NOTERE

Merita Paj
[Signature]



SHOQERIA TREGTARE
"ZBULO FATIN" sh.a.

Nr.23/05

V E N D I M
i
AKSIONERES SE VETME

Sot me dt.27.06.2005, ne seline Shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a. ne Tirane, une Vilma NUSHI, aksionere e vetme e kesaj shoqerie, mora ne shqyrtim ceshtjen lidhur me transferimin e selise se Shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a. dhe

V E N D O S A


Selia e Shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a. te ndryshoje nga adresa Rr."Dede Gjon Luli", P.3/1, Tirane, ne adresen e re :

Katundi i Ri – Kashar, Autostrada Tirane – Durrës, kilometri 10, Tirane

Per sa me siper te pasqyrohet ky ndryshim ne te gjithe dokumentacionin e shoqerise.

Aksionere e Vetme e
Shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a.

Vilma Nushi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3596 Rep.
Nr. 424 Kol.

VERTETIM

Sot me dt. 11/7/2005, perpara meje notere Shirvan Topaj, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane, u paraqit personalisht znj. Vilma Nushi, shtetase shqiptare, e bija e Besnikut dhe e Shpreses, e datelindjes 30.06.1961, lindur dhe banuese ne Tirane, ne adresen Rr"dede Gjon Luli", P.3/1, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me identitetin e te ciles u njoha nepermjet pasaportes me nr.0012159, e cila me deklaroi permbajtjen e ketij akti te hartuar jashte kesaj zyre dhe te nenshkruar me vullnetin e saj te lire dhe te plote, dhe une noterja e vertetova ate sipas ligjit.

NOTERE

Shirvan Topaj
[Signature]



28385/2

KERKESE

3 B MUCO
18 02
12 KORIK 2005



Kerkues : Shoqeria "ZBULO FATIN" sh.a., e perfaqesuar nga Drejtorja e shoqerise znj. Majlinda Hido, e bija e Besnikut dhe Shpreses, lindur ne Tirane me 04.05.1958, banuese ne Tirane ne Rr. "Dede Gjon Luli", P.3/1, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Objekti : Depozitimi i dokumenteve te shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a. per transferimin e selise se shoqerise ne nje adrese te re, ne mbeshtetje te ligjit 7667, dt. 28 janar 1993.

*Te depozitohet
te shprehur dt*

PERPARA

Gjykates se Rrethit Tirane

12.07.05

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.28385, dt.11.10.2002 eshte bere regjistrimi ne Regjistrin Tregtar prane kesaj gjykate i Shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a, me aksionere te vetme zonjen Vilma Nushi.

Mbeshtetur ne ligjin 7638,dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me vendimin nr. 23/05, dt.27.06.2005, aksionerja e vetme e shoqerise ka vendosur :

*Vendimi i Aksionerit
te vetme
dt 27.6.05*

Te transferoje seline shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a. nga adresa Rr."Dede Gjon Luli", P.3/1 Tirane, ne adresen e re : Katundi i Ri - Kashar, Autostrada Tirane - Durres, kilometri 10, Tirane.


Sa me siper, i kerkoj Gjykates te pranoje kerkese per depozitim ne Regjistrin Tregtar te vendimit te aksioneres se vetme te shoqerise "ZBULO FATIN" sh.a.

Kerkuesi

Majlinda HIDO, Drejtore e shoqerise
"ZBULO FATIN" sh.a.



KËRKE SË



3 B Mujon
2003 06 0000
[Signature]

KËRKUES: Majlinda Hida, shtetase shqiptare, e bija e Besnikut dhe e Shpresës, e datëlindjes 04.05.1958, lindur dhe banuese në Tiranë, në adresën Rruga "Ded Gjon Luli", Nr. 3/1, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, me identitetin e të cilës u njoha nëpërmjet pasaportës me nr. 0571013.

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimit të Aksioneres së Vetme të Shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.a., datë 22.06.2005, për shtimin e objektit të veprimtarisë.

PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

I nderuar Zoti Kryetar,

Si veprimtar
TIRANË
[Signature]

Shoqëria Tregtare "ZBULO FATIN" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.28385, datë 11.10.2002 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Me cilësinë e Drejtores së shoqërisë, paraqes këtë kërkesë përpara kësaj gjykate për depozitimin e Vendimit të Aksioneres së Vetme të Shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.a., të datës 22.06.2005. Me anë të këtij vendimi, aksionerja e vetme e shoqërisë ka vendosur për shtimin e objektit të veprimtarisë.

Ky vendim është marrë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë. Për këto arsye kërkoj depozitimin e vendimit të mësipërm të Aksioneres së Vetme të Shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.A., datë 22.06.2005.

KËRKUESE

Majlinda HIDA

[Signature]



28385/1



KËRKESË

KËRKUES: Majlinda Hido, shtetase shqiptare, e bija e Besnikut dhe e Shpresës, e datëlindjes 04.05.1958, lindur dhe banuese në Tiranë, në adresën Rruga "Ded Gjon Luli", Nr. 3/1, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, me identitetin e të cilës u njoha nëpërmjet pasaportës me nr. 0571013.

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimit të Aksioneres së Vetme të Shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.a., datë 22.06.2005, për ndryshimin e objektit të veprimtarisë.

PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

E. M. M. M.
[Signature]

I nderuar Zoti Kryetar,

*67 depozitimet
tekuem dit*

Shoqëria Tregtare "ZBULO FATIN" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.28385, datë 11.10.2002 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit. *23-06-05*

Me cilësinë e Drejtores së shoqërisë, paraqes këtë kërkesë përpara kësaj gjykate për depozitimin e Vendimit të Aksioneres së Vetme të Shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.a., të datës 22.06.2005. Me anë të këtij vendimi, aksionerja e vetme e shoqërisë ka vendosur për ndryshimin e objektit të veprimtarisë.

Ky vendim është marrë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë. Për këto arsye kërkoj depozitimin e vendimit të mësipërm të Aksioneres së Vetme të Shoqërisë "ZBULO FATIN" Sh.A., datë 22.06.2005. *23-06-05*

KËRKUESË

Majlinda HIDO

[Signature]

ZBULO FATIN sh.a
Rr. "Ded Gjon Luli" No. 3/1
TIRANA - ALBANIA

KERKESE

E A Capo
11 10 2002
[Signature]
28385

KERKUESI : Majlinda HIDO, Drejtore e Shoqerise, me kombesi e shtetesi Shqiptare, e datelindjes 04.05.1958, me pasaporte nr.0571013 dhe adrese Rruga "Dede GJOLULI", NR.1, Tirane.

OBJEKTI: Rregjistrimi i shoqerise "ZBULO FATIN" SH.A. PA OFERTE PUBLIKE, sipas ligjit "Per shoqerite tregetare" Nr. 7638, date 19.11.1992 dhe ligjit Nr.8701, date 01.12.2000 "Per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet".

PERPARA

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Z. GJYQTAR

1. Sipas Ligjit "Per shoqerite tregetare" Nr. 7638, date 19.11.1992 dhe Ligjit Nr.8701, date 01.12.2000 "Per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet", kerkojme rregjistrimin e shoqerise "ZBULO FATIN" SH.A. pa oferte publike me kapital themeltar 10.000.000 (dhjete milione) Leke, te ndare si me poshte:

- a. Aksioneri Vilma Nushi, me 100 % (per/qind) te aksioneve, me vlere te pergjithshme 10.000.000 (dhjete milion) Leke, te Kapitalit me numer te aksioneve nga nr. 1 deri tek nr. 100.

Shoqeria ka objektin e aktivitetit si me poshte:

Ushtrimi i veprimtarise ne fushen e lojrave te fatit, te percaktuar ne Ligjin Nr.8701 date 1.12.2000 "Per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet".

Selia e Shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes ne adresen : Rr."Dede GJOLULI", Nr. 3/1, Tirane, Shqiperi me kohezgjatje jo me pak se 20 vjet.

Drejtore i Shoqerise eshte Majlinda HIDO.

Per sa me siper kerkojme rregjistrimin e Shoqerise "ZBULO FATIN" SH.A. sipas ligjit.

DREJTORI

Majlinda HIDO

[Signature]

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



R.SHQIPERISE